



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 33/2015

Prishtinë, më 13.10.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I Mbledhjes së Komisionit për Zhvillim Ekonomik,
Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Besim Beqaj, Blerim Grainca Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

I ftuar: Lutfi Zharku, ministër i Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Valmire Maloku, Nazmi Jashari, Milaim Ahmetaj dhe Nebih Shatri – Ministria e Infrastruktutrës; Dardan Abazi – INDEP; Fjolla Uka – KDI dhe Shefki Kastrati – NDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjessë datës 6.10.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Raif Qela – Propozoi që të futet në rendin e ditës pika me temën “Përmirësimi i mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura që i raportojnë Kuvendit”.

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se edhe në mbledhjen e kaluar kemi biseduar që të organizojmë një punëtori së shpejti me përkrahjen e Institutit INDEP, por kërkoj që të vendos Komisioni se a pajtohet që kjo çështje të vendoset apo jo në rend dite.

Deputetët votuan njëzëri që “rendi i ditës” të plotësohet edhe me pikën e rendit të ditës të propozuar nga z. Qela.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.10.2015;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 6.10.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-064 për Patentë Shofer

Kryetari tha se për këtë pikë të rendit të ditës është ftuar ministri i Infrastrukturës, z. Lutfi Zharku, dhe ia kaloi fjalën ministrit për të arsyetuar në parim Projektligjin për Patentë Shofer.

Lutfi Zharku, ministër i Infrastrukturës, fillimisht tha se me programin legjislativ për vitin 2015 është paraparë miratimi i projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor. Ndërkohë, ministria gjatë takimeve për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit ka marrë rekomandime që ligjin për siguri në komunikacion ta ndajë në tri projektligje, në projektligjin për patentë shofer, projektligjin për rregullat në komunikacionin rrugor dhe projektligjin për automjete. Projektligji për patentë shofer ka për qëllim përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së, të sigurojë cilësi në procesin e aftësimit dhe vlerësimit të kandidatëve për shoferë si dhe të lehtësojë kushtet për bërje biznesi. Ky ligj është i një rëndësie të posaçme, për shkak se do të mundësonte ngritjen e cilësisë së shërbimeve, ngritjen e normave të sigurisë, ngritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e normave për regjimin e ngasjes, ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e patentë shoferëve si dhe mbrojtjen e pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor. Zbatimi i projektligjit nuk parasheh implikime buxhetore shtesë. Projektligji për patentë shofer rregullon edhe çështjet që kanë munguar në ligjin ekzistues. Licencimi për kategoritë tjera tash bëhet pa e kushtëzua me kategorinë “B”, derisa me ligjin ekzistues për të marrë licencën për kategoritë “C” dhe “D”, është dashtë të posedojë licencën për kategorinë “B”. Me këtë projektligj rregullohet edhe pozita e udhëheqësit profesional në auto shkollë, ndërsa me ligjin ekzistues nuk ka qenë e rregulluar. Po ashtu, me këtë projektligj është bërë edhe rritja e fondit të orëve nga pjesa teorike dhe praktike. Personat e emëruar nga ministria për mbajtjen e provimit për patentë shofer janë të ndarë për pjesën teorike dhe praktike, kurse në ligjin aktual kjo çështje nuk është e ndarë. Me këtë projektligj rregullohet edhe ruajtja e kualiteteve për pyetës me provime periodike. Po ashtu me këtë projektligj rregullohen edhe trajnimet dhe provimet për shoferë profesionistë, duke u bazuar në direktivat evropiane. Marrja e patentë shoferëve të kategorive të rënda “C” dhe “D”, është

e bazuar në direktivën evropiane. Subjektet e autorizuar nga ministria që ofrojnë shërbime për patentë shoferë i nënshtrohen kushteve dhe kriterëve shtesë duke rritë cilësinë e shërbimeve dhe konkurrencës lirë. Mbikëqyrja e subjekteve që merren me patentë shofer është rregulluar me këtë projektligj, ndërsa me ligjin ekzistues nuk ka qenë e rregulluar. Me këtë projektligj jemi mundu të zgjidhim konfliktin e interesit, që zyrtarët e ministrisë në trajnimet nga subjektet e autorizuar nga ministria nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në vlerësimin e tyre në rastin e licencimit apo çfarëdo forme të vlerësimit të organizuar nga ministria, me ligjin ekzistues nuk ka qenë e rregulluar për angazhimet shtesë të zyrtarëve.

Kryetari tha se ky projektligj sjell risi që janë të rëndësishme, precizimi i procedurave të caktuara, ngritja e standardeve në nivele evropiane dhe evitimi i konfliktit të interesit, janë çështje që ne i përkrahim. Kryetari Mustafa, ngriti disa çështje për diskutim si rendin e aftësimin dhe vlerësimit të kandidatëve, a do të hyjnë përnjëherë në provim apo mund të japin njërin pjesë të provimit më herët kurse pjesën tjetër më vonë. Po ashtu ngriti për diskutim decentralizimin e komisioneve, të cilat tha se janë mjaft të centralizuara, në mënyrë që të ketë vende më shumë ku jepen shërbimet për patentë shofer. Mustafa ngriti edhe çështjen e kualifikimeve të ligjëruesve profesionalë dhe afatin e licencës. Ai iu referua deklaratimit të ministrit se nuk do të ketë pjesëmarrje të zyrtarëve të ministrisë në Komisione të vlerësimit dhe e konsideroi këtë qasje si mjaft të rëndësishme. Në fund të fjalës së tij z.Mustafa, tha se ky projektligj është mjaft i mirë dhe sjell risi të rëndësishme.

Raif Qela tha se ky projektligj shumë më mirë do të plotësojë fushën e patentë shoferëve. Ky projektligj mbulon të gjitha fushat që duhet të rregullohen dhe tha se duhet Ota përkrahim në parim projektligjin, e mandej gjatë fazës së mëvonshme të shohim eventualisht ndonjë plotësim apo ndryshim. Lidhur me nenin 86, ai pyeti përse është kufizimi prej dy vitesh? Deputeti Qela tha se shpeshherë projektligjit, qëllimi i parë i projektligjit thuhet është harmonizimi me legjislacionin e BE-së, në të vërtetë qëllimi i parë është rregullimi i fushës, ndërsa si qëllim i dytë harmonizimi me legjislacionin e BE-së.

Sala Berisha-Shala tha se ligji për sigurinë në komunikacion është paraparë me këtë legjislaturë edhe me legjislaturën e mëhershme dhe, tha se është mirë që është ndarë në tri projektligje. Qëllimi i këtij projektligji është ngritja e sigurisë në komunikacion rrugor. Ne si Komision parlamentar, tha ajo, o ta japim kontributin gjithnjë në bashkëpunim me ministrinë. Shpresojmë të organizojmë edhe një dëgjim publik gjatë fazës së amendamentimit, t'i thërrasim të gjithë aktorët kryesorë, sepse është një projektligj shumë i rëndësishëm dhe duhet ta përkrahim në parim projektligjin për patentë shofer, tha në fund të fjalës së saj znj. Berisha-Shala.

Fatmir Rexhepi pyeti se a janë të rregulluara me këtë projektligj pikët negative.

Duda Balje pyeti ministrin se a kanë menduar se shoferëve rënia iu lejohet dy vitet e para dhe se kanë me kalua edhe jashtë vendit.

Ministri Lutfi Zharku tha se pikët negative rregullohen me projektligjin për rregullat e sigurisë në komunikacion, e jo me këtë projektligj, për çështjet tjera të ngritura do të përgjigjet drejtori i Departamentit të Automjeteve z.Nebih Shatri.

Nebih Shatri (Ministria e Infrastrukturës), tha se sa i përket projektligjit për patentë shoferë, qëllimi është harmonizimi më i plotë me direktivat e BE-së, në mënyrë që patentë shoferi të pranohet nga të gjitha vendet. Ne, shtoi ai, gjatë hartimit të këtij projektligji jemi mbështetur në praktikën slovene. Ai sqaroi se i kemi dy kategori; shoferët e rinj dhe shoferët fillestarë. Shoferët e rinj, janë deri në moshën 24 vjeçare, sepse është konstatuar se kjo moshë e shoferëve është kategori më e rrezikshme në komunikacion, dhe për këtë kategori është menduar të ketë një periudhë prej dy vitesh. Ndërsa, shoferë fillestarë janë ata shoferë që e marrin patentë shoferin për herë të parë, ata mund ti kenë edhe 40 apo 50 vjet. Sa i përket kufizimeve, Shatri tha se janë bazuar në ligjin kroat sepse kufizime për ndalim të ngasjes gjatë natës apo kufizime të ngjashme për fillestarë nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, është konsideruar si shkelje e të drejtave të njeriut, andaj, edhe ne nuk kemi vendosur kufizime të tilla, pasi që edhe vendet tjera evropiane nuk kanë kufizime të tilla. Kufizime ka vetëm në kategorinë “A”, ndërsa, në kategoritë tjera nuk ka. Lidhur me ligjëruesit profesionalë, ai tha se me këtë projektligj janë vendosur kërkesa për kualifikime të larta shkollore, ndërsa në ligjin ekzistues ka mundësi secili të bëhet ligjërues profesionalë në auto shkolla.

Ministri Lutfi Zharku shtoi se ekzaminuesit (pyetësit) me këtë projektligj nuk janë më shërbyes civilë, por janë të jashtëm. Ata do të aftësohen dhe do të japin provimin sipas procedurave të caktuara me këtë projektligj. Njësia e patentë shoferëve ofron shërbime në qendrat kryesore të vendit por nëse shihet e nevojshme dhe ka buxhet, atëherë do të shqyrtohet edhe mundësia që të zgjerohet edhe në ndonjë komunë tjetër ofrimi i shërbimeve për patentë shofer. Me këtë projektligj orët e detyrueshme praktike janë rritur nga 16 sa ka qenë, në 30 orë praktike, me qëllim që kandidatët të aftësohen më mirë për të rritur sigurinë në komunikacion.

Duda Balje pyeti se çka bëni që të njihet patentë shoferi i një vendi të huaj, sepse tha ajo, ka persona që e kanë marr patentë shoferin në Serbi, Bosnje apo ndonjë vendi tjetër.

Nebih Shatri (Ministria e Infrastrukturës), tha se për të njohur patentë shoferin e një vendi tjetër, ministria e shqyrton programin e atij vendi, nëse ai vend e ka programin e harmonizuar me Bashkimin Evropian, ai patentë shofer pranohet, nëse nuk e ka të harmonizuar atëherë nuk do të njihet.

Kryetari tha se për njohjen e patentë shoferëve mund të ketë edhe marrëveshje bilaterale mes vendeve, por mund të ketë edhe reciprocitet në njohjen e patentë shoferëve. Duhet të kontaktojmë me vendet fqinje, sepse problemet më të mëdha shoferët i kanë me vendet fqinje, me i harmonizuar programet e njohjes reciproke të patentë shoferëve. Nëse ndonjë vend i diskrediton shoferët tanë edhe ne duhet të veprojmë me reciprocitet.

Fatmir Rexhepi tha se nuk duhet të vendosim rregulla që e vështirësojnë levizjen e qytetarëve dhe si shembull ai iu referua ndërrimit të tabelave nga KS në RKS, e cila ka vështirësuar qarkullimin e lirë dhe ka shkaktuar mosnjohje të tabelave, ndërsa në asnjë shtet në Evropë nuk e kemi një praktikë të tillë të shenjave të ngjashme në tabela.

Kryetari tha se qëllimi është që mos ta komplikojmë jetën e qytetarëve, dhe shtoi se është mirë të kontaktohet me vendet fqinje që ti harmonizojmë programet, në mënyrë që mos të ketë probleme në njohjen e patentë shoferëve.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-064 për Patentë Shofer.

Komisioni mori vendim për formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji në përbërje: Sasha Milosavljeviq, kryesues, Raif Qela dhe Pal Lekaj, anëtarë.

4. Përmirësimi i mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura;

Raif Qela në cilësinë e propozuesit të kësaj pikë të rendit të ditës elaboroi arsyen e nevojës së diskutimit për këtë çështje. Ai në vazhdim tha se asnjë nga ne nuk është i kënaqur me mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura, dhe shprehu mendimin se duhet të fuqizohet mbikëqyrja dhe komunikimi me institucionet e pavarura. Aktualisht shtoi ai, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në bazë të Kushtetutës deri tash janë themeluar 5 institucione të pavarura, ndërsa 29 janë themeluar me ligje të veçanta, do të thotë gjithsej janë 34 institucione të pavarura. Në kuadër të zyrës së sekretarit, është një zyrtar ndërlidhës, i cili bënë një bashkërendim mes Kuvendit dhe këtyre institucioneve, dhe kjo është e pamjaftueshme. Tash po bëhet njëfarë ristrukturimi në administratë dhe ky person po bartet diku tjetër e jo i lidhur drejtpërdrejt me Sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit, që do ta vështirësojë edhe më shumë komunikimin tonë me këto institucione. Ai potencoi se është e pamundur të mbikëqyren këto institucione me një raport 1 (njëherë) në vit, prandaj komunikimi dhe mbikëqyrja e institucioneve të pavarura duhet të përmirësohen. Ai njoftoi se në Shqipëri ekziston një departament i veçantë i administratës i përbërë prej 7 (shtatë) vetash i cili bënë mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe i ofron deputetëve raporte të vazhdueshme, andaj, të krijohet edhe këtu një departament i veçantë për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura. Se kemi informacione të pamjaftueshme lidhur me rrjedhat në institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit dhe se komunikimi që e kemi me to është i pamjaftueshëm, dëshmon p.sh. vetëm ky fakt: Gjatë shqyrtimit të Raportit vjetor për vitin 2014 të ARKEP-it, kryetari i Bordit të ARKEP-it, z. Ekrem Hoxha, tha: "...autoriteti është në fazën finale të përmbylljes të dhënies së kapaciteteve shtesë frekuencore të dy operatorëve të autorizuar. (...) autoriteti brenda tre mujorit të 3-të të këtij viti do t'i ndanë resurset shtesë me çka operatorët do të kenë edhe këtë aset të munguar të frekuencave shtesë." Komision dhe Kuvendi nuk ka marrë asnjë informatë plotësuese se përse nuk është realizuar akoma ky premtim i Kryetarit të Bordit të ARKEP-it. Përse akoma nuk është dhënë në shfrytëzim ky resurs të cilin e kemi? Pse të mos u jepen dy operatorëve të telefonisë mobile licencat për operim edhe me brezin frekuencor 2100 MHz, derisa nuk ekziston asnjë pengesë për këtë dhe përderisa ata kanë filluar ta ofrojnë shërbimin 4G? Pa këto frekuenca shtesë interneti në telefona mobilë është për nja 4-fish më i ngadalshëm

sesa sikur dy operatorëve të licencuar të telefonisë mobile t'u jepeshin edhe ato. Në këtë mënyrë konsumatorët privohen nga një e drejtë, kurse biznesi i operatorëve dëmtohet.

Kryetari tha se e kemi edhe me plan të punës të diskutojmë për institucionet e pavarura, mirëpo, roli i Komisionit është të komunikojë me bordin e agjencisë së caktuar e jo me menaxhmentin, andaj edhe kanë mbet pa u shqyrtuar disa raporte të disa institucioneve të cilat nuk kanë pas bord. A duhet të bëhet departament i veçantë apo të fuqizohet stafi i komisioneve, kjo mbetet të diskutojmë dhe të gjejmë alternativën më të mirë. Gjithashtu kryetari ngriti si çështje se si Komision a kemi të drejtë të diskutojmë për të gjitha institucionet e pavarura apo vetëm për institucionet e pavarura të cilat i raportojnë këtij Komisioni. Ai tha se Komisioni mund të organizohet në grupe nga dy apo tre deputetë, të cilët do të orientohen në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura të caktuara, të cilët do të kujdesen më shumë për mbikëqyrjen e institucioneve.

Sala Berisha-Shala pohoi se jemi vonuar pak me mbajtjen e tryezës, me theks të veçantë për institucionet e pavarura, të cilat i përgjigjen Komisionit. Ajo shtoi se duhet kohë për me analizua a duhet të organizohet brenda stafit apo departament i veçantë për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura. Edhe ne si deputetë mundemi me u nda ne grupe për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe kohë pas kohe ta informojmë Komisionin për të gjeturat nga mbikëqyrja.

Fatmir Rexhepi tha se duhet të gjejmë mënyrën më të mirë për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura me sa më pak implikime buxhetore. Idenë për departament të veçantë z. Rexhepi e vlerësoi si ide jo të mirë, dhe, më të arsyeshme e vlerësoi idenë që në kuadër të Komisioneve të organizohet stafi i Komisioneve për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura.

Kryetari duke u ndërlidhur me temën, tha se do të organizojmë punëtorin që do ta përkrahë INDEP-i, të cilit kanë bërë një hulumtim dhe, nga punëtorja do të nxjerrim konkluzionet për mënyrën e fuqizimit të mbikëqyrjes së agjencive të pavarura. Gjithashtu, në kuadër të administratës ekziston edhe një drejtori për hulumtime, e cila mund të shfrytëzohet për hulumtime ose të gjendet mundësia që në kuadër të njësisë së Komisionit të sillet edhe një zyrtar nga brenda administratës së Kuvendit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

Konkluzion

- 1. Të organizohet punëtorja për agjencitë e pavarura që i raportojnë Kuvendit në bashkëpunim me INDEP-in, në fillim të muajit nëntor të këtij viti;*
- 2. Anëtarëve të Komisionit t'iu dërgohet lista e agjencive të pavarura që i raportojnë Komisionit dhe deputetët mund të organizohen në grupe nga dy apo tre deputetë, të cilët do të orientohen në mbikëqyrjen e agjencive të pavarura të caktuara.*

5. Të ndryshme.
Çështje vijuese

Kryetari Mustafa njoftoi anëtarët e Komisionit se ai dhe deputeti Fatmir Rexhepi, do të marrin pjesë në një konferencë ndërparlamentare të organizuar nga Parlamenti Evropian me temën “Qeverisja ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës në BE dhe vendet kandidate potenciale për zgjerim të BE-së”, e cila do të mbahet më 15 dhe 16 tetor në Sarajevë të Bosnje dhe Hercegovinës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa